



## VENDIM

*Nr. 111 Datë 18.11.2014*

### **FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr. 80, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me pakice te energjise elektrike“ Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës **18.11.2014**, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015 si dhe relacionin e grupit të punës,

#### **Konstatoi se:**

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit me pakicë,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës për aktivitetin e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**

**VENDIM**

*Nr. 111 Datë 18.11.2014*

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS  
PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR VITIN 2015**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____